



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 611/7 prot.

Datë 28.05.2024.

V E N D I M
Nr. 591/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 28.05.2024, shqyrtoi kërkesën me:

Objekt: “Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Eko-Studio-Projekt” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, e thjeshtuar”, me Nr.REF-94828-02-08-2024, me objekt “Monitorimi i Parametrave Mjedisore dhe Hartimi i Raporteve Mjedisore per Landfillin”, me fond limit 3,000,000 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 20.02.2024, nga autoriteti kontraktor, ECO-ELB SHA.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Tenuis Laboratories” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Ankimues: Operatori ekonomik “Eko-Studio-Projekt” SHPK me NIPT (L03614803Q), me adresë: Njësia Bashkiake Nr.5, Bulevardi “Gjergj Fishta”, Godina Nr.48, Kati i parë, Tiranë

Operatori ekonomik “Tenuis Laboratories” SHPK me NIPT (L81904506I), me adresë: Rruga dytësore “Maminas – Vorë”, Nr. 20/38, Koxhas, Durrës.

Autoriteti Kontraktor: ECO-ELB SHA, me adresë: Lagja “Brigada 17 Sulmuese”, Bulevardi “Qemal Stafa”, Elbasan

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të. Gjithashtu, KPP konstatoi se ankesat e operatorëve ekonomikë janë paraqitur për të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.3. Operatorët ekonomikë ankimues, kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 09.02.2024, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “Procedurë e hapur, e thjeshtuar”, me Nr.REF-94828-02-08-2024, me objekt

“Monitorimi i Parametrave Mjedisore dhe Hartimi i Raporteve Mjedisore per Landfillin”, me fond limit 3,000,000 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 20.02.2024, nga autoriteti kontraktor, ECO-ELB SHA.

II.2. Në datën 20.02.2024, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Në datën 07.03.2024, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “Tennis Laboratories” SHPK	1,500,000	skualifikuar
2. “Alpha Studio” SHPK	1,520,000	skualifikuar
3. “Eko Studio Projekt” SHPK	1,572,000	skualifikuar
4. “Qendra e Monitorimit të Mjedisit” SHPK	1,580,000	kualifikuar

II.4. Në datën 08.03.2024, në Sistemin e Prokurimit Elektronik është publikuar Njoftimi i Fituesit Paraprak të procedurës së prokurimit.

II.5. Operatori ekonomik “Eko-Studio-Projekt” SHPK rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit me arsyetimin se:

“OPERATORI “Eko Studio Projekt”

Operatori “ Eko Studio Projekt ” nuk permbush piken 2.3.3 te Dst 2.3.3 Operatori Ekonomik, duhet të sigurojë të paktën 1 (një) mjet në pronësi ose me qira për të bërë të mundur lëvizjen e instrumenteve dhe pajisjeve laboratorike, për realizimin e projektit.

• Për mjetet që janë në pronësi duhet të paraqiten dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit leja e qarkullimit: certifikatën e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit i vlefshëm.

• Për mjetet që janë me qira krahas dokumentit të mësipërm duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë.

OE “ Eko Studio Projekt “ ne lidhje me 3 mjetet qe disponon :

Ka ngarkuar ne sistem vetem ÇERTEFIKATA E PRONËSISË SË MJETIT RRUGOR dhe vertetim nga Drejtoria e Pergjithshme e Sherbimeve te Transportit Rrugor (DPSHTRR) ku verteton se nuk eshte debitor per taksen vjetore te mjeteve te perdorura , gjoba te kontrollit Teknik , gjoba te kontrollit ne rruge dhe nuk eshte bllokuar nga organet kopetente , por nuk ka ngarkuar asnje nga dokumentat e me poshte kerkuar sic jane leja e qarkullimit , certifikata e kontrollit Teknik dhe siguracioni I mjetit te vlefshem.

Operatori “ Eko Studio Projekt ” nuk permbush piken 2.3.4 te Dst

2.3.4 Operatori Ekonomik duhet të disponojë përpara datës së shpalljes së kësaj gare, si pjesë të stafit të tij, Inxhinier Mjedisori me diplomë master si dhe të paktën një specialist/e të diplomuar me master në Kimi ose diploma të ngjashme me to.

Ne lidhje me piken 2.3.4 ku kerkohet qe subjekti te kete te punesuar nje Kimist OE ka paraqitur vetem Kontraten Individuale te Punes dhe nje Cv por nuk ka ngarkuar nje document (Diplome) ku te vertetohet se punonjesja eshte e kualifikuar sic kerkohet ne piken 2.3.4 te Dst.

Operatori “ Eko Studio Projekt ” nuk permbush pikën 2.3.5 të DST

2.3.5 *Operatori Ekonomik, duhet të vërtetojë se mund të sigurojë të paktën 1 (një) pajisje laboratorike, për të bërë të mundur matjen e cdo parametri te listuar. OE duhet të paraqesë një deklaratë, ku për çdo parametër të listuar në shtojcën Nr.5 të vërtetojë se disponon një pajisje laboratorike dhe të shpjegojë se si do të realizohet matja e secilit parametër.*

** Faturën e blerjes (në rast pronësie) ose*

** Kontratën e qirasë (në rastin e marrjes me qira).*

OE "Eko Studio Projekt" ka paraqitur vetem nje prezantim te subjektit, punes qe kryen , organigrames dhe teresise se pajisjeve qe disponon duke mos dorezuar nje deklarate sic kerkohet ne piken 2.3.5 te dst ku te jepet shpjegim per pajisjet laboratorike qe do te perdoren dhe menyra e perdorimit te tyre ,vetem per parametrat e listuar ne shtojcen 5 .

Sa mesiper, operatori " Eko Studio Projekt " nuk kualifikohet në lidhje me këto kriteret.

Në LPP nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", neni 92, pika 3, parashikohet se: 3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji."

II.5.1. Në datën 11.03.2024 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. aplikimi të ankesës online A/2024/3887 datë 11.03.2024 dhe me nr. protokollit 611/2024, e operatorit ekonomik "Eko-Studio-Projekt" SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik "Eko-Studio-Projekt" SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.5.2. Në përputhje me nenin 112 "Veprimet paraprake" të Ligjit nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik", Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 611/2 prot., datë 12.03.2024, duke publikuar arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik "Eko-Studio-Projekt" SHPK.

II.5.3. Nga verifikimi në Sistemin e Ankesave Elektronike, konstatohet se, në datë 26.03.2024, operatori ekonomik "Eco-Studio-Project" SHPK, ka paraqitur mandat - pagesën që mban datën 26.03.2024.

II.5.4. Me anë të shkresës nr. 611/3 prot., datë 17.05.2024 me objekt "Mbi detyrimin e autoritetit kontraktor për dhënie informacioni KPP-së lidhur me ankesat e operatorëve ekonomikë "Eko-Studio-Projekt" SHPK dhe "Tenuis Laboratories" SHPK", Komisioni i Prokurimit Publik, i është drejtuar autoritetit kontraktor, duke kërkuar informacion në lidhje me procedurën e prokurimit, konkretisht: "[...] Me anë të shkresës Nr.173 prot., datë 21.03.2024, protokolluar me tonë me nr. 646/3 prot., datë 26.03.2024, institucioni juaj ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik vetëm aktin e trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues "Tenuis Laboratories" SHPK, ku konstatohet se ankesa e këtij të fundit

është refuzuar, por nuk është dërguar asnjë informacion në lidhje me procedurën e prokurimit, si dhe lidhur me trajtimin e ankimit elektronik me nr. A/2024/3887 datë 11.03.2024 dhe me nr. protokollin 611/2024, të operatorit ekonomik “Eko-Studio-Projekt” SHPK.

Sa më sipër, me qëllim vijimin e gjykimit të ankesës pranë KPP-së në përputhje me nenin 114 të LPP-së, autoriteti kontraktor të dërgojë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e kësaj shkrese, të gjithë informacionin e hollësishëm mbi procedurën e mësipërme të prokurimit, ku të pasqyrohet procesi i shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave të paraqitura në këtë procedurë prokurimi, si dhe akti i trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik “Eko-Studio-Projekt” SHPK.”

II.5.5. Me anë të shkresës Nr.231/1 prot., datë 21.05.2024, protokolluar me tonë me nr. 611/4 prot., datë 22.05.2024, me objekt “Kthim përgjigje”, autoriteti kontraktor ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, informacion mbi procedurën e prokurimit ku ndër të tjera citon se: “[...] “Eko-Studio-Projekt” SHPK, me nr. Aplikimi të ankesës online: A/2024/3887, datë 11.03.2024, është administruar nga AK pasi rezulton se “statusi i mandat pagesës: Pa paraqitur” (bashkangjitur, bazuar VKM Nr. 285, datë 19.05.2021, neni 94, pika 3 paragrafi 2-3, “Ankimuesi është i detyruar të bëjë pagesën e tarifës pranë Komisionit të Prokurimit Publik. Ankimuesi duhet ti bashkëlidhe formularit të ankesës, dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën pranë Komisionit të Prokurimit Publik. Kur është e mundur, ankimit i bashkëlidhet një kopje e aktit, që kundërshtohet.” Gjendur në këto kushte nga autoriteti kontraktor u ndërmorën masa mbi njoftimin e operatorit ekonomik “Eko-Studio-Projekt” SHPK në rrugë elektronike në email zyrtar të OE në datën 20.03.2024. (bashkangjitur emaili). Referuar VKM Nr. 285, datë 19.05.2021, Neni 94 “Paraqitja e ankesave” pika 5 “Ankesa duhet të korigjohet dhe paraqitet në autoritetin/entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik brenda 2 (dy) ditëve, duke depozituar në rrugë elektronike ose postare mandat pagesën. OE ka kthyer përgjigje në rrugë elektronike por nuk ka paraqitur dokumentin e kërkuar nga AK. Operatori ekonomik nuk ka ngarkuar manda pagesën brenda këtij afati ligjor. Referuar VKM nr.285 datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 94 pika 5, paragrafi i dytë, “Nëse ankesa nuk korigjohet/plotësohet brenda këtij afati, ajo vlerësohet si e paparaqitur.”

Operatori ekonomik ka dorëzuar në rrugë elektronike mandat pagesën e cila mban datën 26.03.2024, pagesa e mandatit nuk është bërë sipas afateve ligjore të parashikuara për paraqitjen e ankesave. Sa më sipër nga ana e autoritetit kontraktor ankesa e “Eko-Studio-Projekt” SHPK, me nr. Aplikimi të ankesës online: A/2024/3887, datë 11.03.2024 është vlerësuar si e paparaqitur dhe si e tillë nuk është marrë në shqyrtim nga ana e AK.”

II.6. Operatori ekonomik “Tenuis Laboratories” SHPK rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit me arsyetimin se:

“OPERATORI “Tenuis Laboratories”

Operatori ekonomik “Tenuis Laboratories” nuk përmbush pikën 2.3.5 të DST

2.3.5 Operatori Ekonomik, duhet të vërtetojë se mund të sigurojë të paktën 1 (një) pajisje laboratorike, për të bërë të mundur matjen e cdo parametri të listuar. OE duhet të paraqesë një deklaratë, ku për çdo parametër të listuar në shtojcën Nr.5 të vërtetojë se disponon një pajisje laboratorike dhe të shpjegojë se si do të realizohet matja e secilit parametër.

* *Faturën e blerjes (në rast pronësie) ose*

* *Kontratën e qirasë (në rastin e marrjes me qira).*

OE "Tenuis Laboratories" në dokumentat e ngarkuara ne sistem ka paraqitur nje deklarate ne te cilen deklararon se permbush te gjitha kerkesat dhe specifikimet per kryerjen e sherbimit per cdo parameter te analizave Kimiko-Fizike , sipas shtojces Nr 5 te Dst , por nuk ka listuar pajisjet laboratorike dhe shpjegimet perkatese se si do te realizohet matja e secilit prej parametrave te listuar ne shtojcen nr. 5 te Dst.

Në LPP nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", neni 92, pika 3, parashikohet se: 3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.

Sa mesiper, operatori "Tenuis Laboratories" sh.p.k. nuk kualifikohet."

II.6.1. Në datën 13.03.2024 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. aplikimi të ankesës online A/2024/3901 datë 13.03.2024 dhe me nr. protokollit 646/2024, e operatorit ekonomik "Tenuis Laboratories" SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik "Tenuis Laboratories" SHPK. Konkretisht operatori ekonomik ankimues pretendon: "[...] Argumenti yne: Laboratori yne ka paraqitur te gjithe dokumentacionin e nevojshem per plotesimin e kriterëve te DST te tenderit me objekt: "Monitorimi i parametrave mjedisore dhe hartimi i raporteve mjedisore (per lendfillin)" me nr.reference REF-94828-02-08-2024.

1. *Ne kemi paraqitur faturat per te gjitha pajisjet per pajisjet qe disponojme (pasi jane ne pronesi te laboratorit) dhe qe sherbejne per kryerjen e analizave te ujrave dhe aparaturat per kryerjen e matjeve ne terren.*

2. *Gjithashtu kemi paraqitur nje deklarate ku zotohemi qe jemi te afte per kryerjen e te gjitha analizave dhe matjeve sipas DST objekt prokurimi.*

3. *Kemi dorezuar dhe listen e akreditimit ku jane te gjitha parametrat qe kerkohen te akredituara dhe ku eshte vendosur edhe teknika, pra instrumenti i cili perdoret per cdo parameter. Theksojme se laboratori eshte i akredituar nga Drejtoria e Pergjithshme e Akreditimit me nr. Certificate LT 122 dhe per cdo parameter, gjeja e pare qe Drejtoria e Akreditimit verifikon eshte instrumenti dhe me pas aftesine e laboratorit per te kryer ate. Kjo certificate eshte nje prove tjeter qe laboratori ka aparaturen per secilen parameter te kerkuar. Ne e kemi dorezuar kete edhe pse nuk eshte kerkuar ky dokument, per te vertetuar qe i kemi te gjitha aparaturat.*

4. *Edhe ne procedurat e meparshme te te njejtit objekt prokurimi dhe te njejtit AK keni patur kerkesa te ngjashme dhe kemi paraqitur te njejtat dokumente por asnjehere nuk eshte ngritur pretendimi qe laboratori ska dokumentet e nevojshme qe te vertetoje pronesine e ketyre aparaturave, pra sna keni skualifikuar! PERSE KETE HERE U NGRIT KY PRETENDIM???* Gjejme te pavend dhe te paprecedent qe kemi mbi nje vit qe merremi pikerisht me kete procedure prokurimi dhe ne menyre flagrante dhe burokratike kapeni pas gjerave qe nuk kane aspak vlere. Konsiderojme se ne si laborator kemi paraqitur dokumente te mjaftueshme qe vertetojme se i kemi ne pronesi ato instrumente. Dhe kjo eshte gjeja me e rendesishme. Nese

autoriteti pret qe te gjithë labororet ti paraqesin provat ne te njejtin format si operatori fitues, do duhej te kishte derguar nje template qe te plotesohet. Pretendimi i autoritetit kontraktues nuk ka te beje fare me thelbin e kerkeses se tyre, por eshte nje perpjekje e vazhdueshme qe te gjeje justifikime per te favorizuar ne menyre jo ligjore nje nga subjektet konkurues!”

II.6.2. Në përputhje me nenin 112 “*Veprimet paraprake*” të Ligjit nr.162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 646/2 prot., datë 18.03.2024, duke publikuar arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “Tenuis Laboratories” SHPK.

II.6.3. Me anë të shkresës Nr.173 prot., datë 21.03.2024, protokolluar me tonë me nr. 646/3 prot., datë 26.03.2024, me objekt “*Vendim i autoritetit kontraktor për ankesën e OE të paraqitur pranë KPP*”, autoriteti kontraktor ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, aktin e trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik “Tenuis Laboratories” SHPK, ku konstatohet, se e ka refuzuar atë.

II.7. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e autoritetit kontraktor, u konstatua se nuk janë paraqitur argumente nga subjekte të interesuara, në përputhje me nenin 113 të “Ligjit për Prokurimin Publik”.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur tyre,

Arsyeton

III.1. Nga shqyrtimi i ankesës së operatorit ekonomik “Eko-Studio-Projekt” SHPK mbi skualifikimin e ofertës së tij ekonomike, si dhe informacionit dhe dokumentacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se operatorit ekonomik ankimues nuk ka kryer brenda afateve të parashikuara ligjore, pagesën e tarifës financiare për paraqitjen e ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me përcaktimet në pikat 2 dhe 4 të nenit 111 të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”.

III.1.1. Në nenin 111 të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, është parashikuar se:
*“1. Operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik.
Rregulla të posaçme për mënyrën e paraqitjes së ankesës përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.*

2. Ankesa bëhet sipas formularit përkatës, ku shënohen emri dhe adresa e ankuesit, referimi për procedurën konkrete dhe bazën ligjore, ku ankuesi pretendon për shkeljet, pagesa e tarifës së ankesës, duke e shoqëruar atë me dokumentacionin dhe provat përkatëse, për të cilat mendon se mbështesin ankimin e tij. Elementet e sipërpërmendura janë të domosdoshme për shqyrtimin e ankesës. Ankimuesi është i detyruar t'i bashkëlidhë ankimit dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën.

3. Nëse mungon ndonjë nga elementet e sipërpërmendura ose formulari nuk është plotësuar në mënyrën e duhur, atëherë autoriteti ose enti kontraktor duhet të vërë në dijeni ankimuesin për të plotësuar formularin. Njoftimi mund të bëhet me çdo mjet të mundshëm, përfshirë edhe postën elektronike, dhe në çdo rast dokumentohet. Nëse ankesa nuk korrigjohet brenda 2 ditëve nga njoftimi, ajo vlerësohet si e paparaqitur.

4. Në çdo rast, paraqitja e ankesës shoqërohet me mandatpagesën e bërë pranë Komisionit të Prokurimit Publik.”

III.1.2. Në pikën 2 gërma “a”, të nenit 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, është parashikuar se:

“2. Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë:

a) të refuzojë ankesën, për shkak të mosplotësimit të elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e saj, sipas parashikimeve të nenit 111 të këtij ligji;”

III.1.3. Në pikat 4, 5 dhe 6 të nenit 94 “Paraqitja e ankesës” të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, është parashikuar:

4. Në rast se autoriteti/enti kontraktor konstaton se ankesa nuk është bërë sipas formularit standard ose i mungon ndonjë prej elementeve të sipërpërmendura ose nuk është shoqëruar me mandat pagesën, duhet të vërë në dijeni ankimuesin për të plotësuar formularin.

Njoftimi mund të bëhet me çdo mjet të mundshëm, përfshirë dhe postën elektronike, dhe në çdo rast dokumentohet.

Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të njoftojë Komisionin e Prokurimit Publik lidhur me veprimet e mësipërme, për korrigjimin e të metave të ankesës.

5. **Ankesa duhet të korrigjohet dhe paraqitet në autoritetin/entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik brenda 2 (dy) ditëve nga njoftimi.**

Nëse ankesa nuk korrigjohet/plotësohet brenda këtij afati, ajo vlerësohet si e paparaqitur.

Nëse afati i fundit bie gjatë ditëve të pushimit zyrtar, atëherë afati i fundit për plotësimin e ankesës do të jetë ditën pasardhëse të punës.

6. Formulari standard i ankesës hartohet nga APP-ja, në bashkëpunim me Komisionin e Prokurimit Publik, dhe është pjesë e dokumenteve standarde të tenderit.

III.1.4. Në datën 11.03.2024 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. aplikimi të ankesës online A/2024/3887 datë 11.03.2024 dhe me nr. protokollin 611/2024, e operatorit ekonomik “Eko-Studio-Projekt” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur

nga operatori ekonomik “Eko-Studio-Projekt” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

III.1.5. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 611/2 prot., datë 12.03.2024, duke publikuar arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “Eko-Studio-Projekt” SHPK.

III.1.6. Nga verifikimi në Sistemin e Ankesave Elektronike, konstatohet se, në datë 26.03.2024, operatori ekonomik “Eco-Studio-Projekt” SHPK, ka paraqitur mandat - pagesën që mban datën 26.03.2024.

III.1.7. Me anë të shkresës Nr.231/1 prot., datë 21.05.2024, protokolluar me tonë me nr. 611/4 prot., datë 22.05.2024, me objekt “Kthim përgjigje”, autoriteti kontraktor ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, informacion mbi procedurën e prokurimit ku ndër të tjera citon se: “[...] “Eko-Studio-Projekt” SHPK, me nr. Aplikimi të ankesës online: A/2024/3887, datë 11.03.2024, është administruar nga AK pasi rezulton se “statusi i mandat pagesës: Pa paraqitur” (bashkangjitur, bazuar VKM Nr. 285, datë 19.05.2021, neni 94, pika 3 paragrafi 2-3, “Ankimuesi është i detyruar të bëjë pagesën e tarifës pranë Komisionit të Prokurimit Publik. Ankimuesi duhet ti bashkëlidhe formularit të ankesës, dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën pranë Komisionit të Prokurimit Publik. Kur është e mundur, ankimit i bashkëlidhet një kopje e aktit, që kundërshtohet.” Gjendur në këto kushte nga autoriteti kontraktor u ndërmorën masa mbi njoftimin e operatorit ekonomik “Eko-Studio-Projekt” SHPK në rrugë elektronike në email zyrtar të OE në datën 20.03.2024. (bashkangjitur emaili). Referuar VKM Nr. 285, datë 19.05.2021, Neni 94 “Paraqitja e ankesave” pika 5 “Ankesa duhet të korigjohet dhe paraqitet në autoritetin/entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik brenda 2 (dy) ditëve, duke depozituar në rrugë elektronike ose postare mandat pagesën. OE ka kthyer përgjigje në rrugë elektronike por nuk ka paraqitur dokumentin e kërkuar nga AK. Operatori ekonomik nuk ka ngarkuar manda pagesën brenda këtij afati ligjor. Referuar VKM nr.285 datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 94 pika 5, paragrafi i dytë, “Nëse ankesa nuk korigjohet/plotësohet brenda këtij afati, ajo vlerësohet si e paparaqitur.”

Operatori ekonomik ka dorëzuar në rrugë elektronike mandat pagesën e cila mban datën 26.03.2024, pagesa e mandatit nuk është bërë sipas afateve ligjore të parashikuara për paraqitjen e ankesave. Sa më sipër nga ana e autoritetit kontraktor ankesa e “Eko-Studio-Projekt” SHPK, me nr. Aplikimi të ankesës online: A/2024/3887, datë 11.03.2024 është vlerësuar si e paparaqitur dhe si e tillë nuk është marrë në shqyrtim nga ana e AK.”

III.1.8. Nga verifikimi i dokumentacionit të mësipërm të dorëzuar nga autoriteti kontraktor, konstatohet se në datë 20.03.2024, autoriteti kontraktor ka njoftuar me anë të postës elektronike operatorin ekonomik “Eco-Studio-Projekt” SHPK, konkretisht citojmë: “Në ankesën e paraqitur pranë KPP për Procedurën me objekt prokurimi “Monitorimi i Parametrave

Mjedisore dhe Hartimi i Raporteve Mjedisore Për landfillin”, statusi i mandatpagesës është “i paraqitur”. (Bashkangjitur imazhi në KPP). Ju faleminderit për mirkuptimin.”

Në përgjigje të këtij email-i operatori ekonomik “Eco-Studio-Projekt” SHPK, me anë të adresës elektronike eko_studio@yahoo.com informon se “Marrë shkas nga mosfunksionimi i portalit eAlbania, kërkojmë nga ana juaj të na vihet në dispozicion mandat pagesa pasi ritheksojmë se është e pamundur të shkarkohet nga portali eAlbania. Nëse është e mundur të na vini në dispozicion mandat pagesën jeni të lutur të na njoftoni për të dhenat që ju nevojiten nga ana jonë.”

III.1.9. Referuar pikës 2 të nenit 111 të LPP-së, Komisioni thekson, se ligjvënësi ka përcaktuar disa elemente të domosdoshme formale për paraqitjen e ankesës njëkohësisht pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor. Një prej elementeve të domosdoshme për paraqitjen e ankesës është edhe dokumenti bankar, që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën. Ndërsa referuar pikës 3 të nenit 111 të LPP-së, Komisioni gjykon, se ligjvënësi i ka dhënë një mundësi ankimesve, që të korrigjojnë ankesat e tyre në rast se konstatohet mungesa e një apo më shumë elementeve formale të përcaktuara në pikën 2 të nenit 111 të LPP-së. Me anë të kësaj mundësie, ligjvënësi ka dashur të përcjellë frymën, se nuk mund t’i refuzohet e drejta e ankimit subjekteve që pretendojnë se dëmtohen ose rrezikojnë të dëmtohen nga një vendimmarrje e autoritetit kontraktor në mënyrë apriori, vetëm për shkak të disa mungesave formale, të cilat mund të korrigjohen lehtësisht brenda një afati të arsyeshëm, që nuk cenon parimin e efijencës në procedurat e prokurimit publik. Bazuar në dispozitën e mësipërme, për të konstatuar mungesat lidhur me elementet formale të ankesës, si dhe për të vënë në dijeni ankimesin lidhur me mungesat e konstatuara, është detyrim i autoritetit kontraktor, i cili duhet të njoftojë menjëherë ankimesin me çdo mjet të mundshëm, duke i lënë 2 ditë kohë për të korrigjuar elementet e domosdoshme formale të ankesës.

Referuar informacionit të autoritetit kontraktor të depozituar në KPP përmes shkresës Nr.231/1 prot., datë 21.05.2024, protokolluar me tonë me nr. 611/4 prot., datë 22.05.2024, me objekt “Kthim përgjigje”, rezulton, se autoriteti kontraktor nëpërmjet komunikimit të postës elektronike, në datë 20.03.2024, ka njoftuar operatorin ekonomik ankimes për ndreqjen e të metave të ankesës, si në rastin konkret kryerjen e pagesës së tarifës për ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor dhe KPP-së. Ndërkohë, që operatori ekonomik ankimes ka ndrequr këto të meta, duke dorëzuar mandat pagesën për ankesën, në datë 26.03.2024, në Sistemin e Ankesave Elektronike, pra përtej afatit dy ditor të përcaktuar nga ligji.

Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin, se përcaktimi i procedurave të caktuara në LPP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, duke filluar nga përgatitja e ofertës, shqyrtimi i ofertave, ankimi, si dhe mundësia për të korrigjuar mangësitë lidhur me elementet e domosdoshme formale të ankesës, përfaqësojnë garanci dhe siguri juridike për palët e interesuara. Parimi i ligjshmërisë është ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike. Gjithashtu, ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar nga lex specialis LPP, janë ato të mosdiskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia e elementeve të mësipërme, lidhet ngushtësisht me elemente të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike.

Së pari, vlen të theksojmë se, operatorët ekonomikë kanë detyrimin që të dorëzojnë ankesën e tyre së bashku me dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës, në përputhje me nenin 111 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Për sa i përket veprimeve të autoritetit kontraktor, në rastin konkret gjykojmë se, ankesa është dorëzuar në datë 11.03.2024 në mungesë të mandatit të pagesës, ndërkohë që autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorin ekonomik ankimues për ndreqjen e të metave, në datë 20.03.2024, në tejkallim të afateve ligjore të parashikuara nga ligji dhe rregullat e prokurimit publik. Megjithatë, këto veprime të autoritetit kontraktor në asnjë moment nuk kanë cënuar të drejtën e operatorit ekonomik ankimues për të ndrequr të mëtat e ankimit të tij.

Sa më sipër, Komisioni Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi faktet dhe provat bashkëlidhur dokumentacionit të dërguar nga autoriteti kontraktor, si dhe verifikimit në Sistemin Elektronik të Ankesave, konstaton se, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorin ekonomik ankimues nëpërmjet postës elektronike, në lidhje me korrigjimin e mangësive të konstatuara në lidhje me elementet formale të ankesës, konkretisht pagesës së tarifës së ankesës, por operatori ekonomik ankimues, e ka plotësuar atë përtej afatit ligjor të parashikuar në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, konkretisht pikës 5 të nenit 94 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

III.1.10. Në këto kushte, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik ankimues nuk është privuar nga mundësia që i jep ligji për të korrigjuar një prej elementeve formale të domosdoshme. Në këtë rast Autoriteti Kontraktor rezulton, se, edhe pse në tejkallim të afateve, ka kryer veprimet e duhura procedurale, duke i kërkuar operatorit ankimues plotësimin e të metave të ankesës në përputhje me Lex Specialis, duke mos e privuar këtë të fundit nga e drejta e ankimit.

Fakti që operatori ekonomik nuk ka reaguar për ndreqjen e të metave **brenda afatit ligjor të përcaktuar**, si në rastin konkret pagimin e tarifës së ankesës, nuk e ka privuar këtë të fundit nga një prej të drejtave tij në procedurat e prokurimit publik, që është ndreqja e të metave të ankesës.

Referuar sa më sipër, në kushtet kur operatori ekonomik ankimues nuk ka paguar tarifën financiare të ankesës, si dhe ka refuzuar ndreqjen e të metave sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 111, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, Komisioni gjykon, se ankesa e operatorit ekonomik ankimues “Eco – Studio - Project” SHPK, nuk plotëson një prej elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e ankesës, ndaj bazuar në gjermën “a” të pikës 2 të nenit 118, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, kjo ankesë duhet refuzuar.

III.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Tennis Laboratories” SHPK SHPK, se arsyeja e skualifikimit të ofertës së tyre ekonomike “Operatori ekonomik “Tennis Laboratories” nuk përmbush pikën 2.3.5 të DST

2.3.5 Operatori Ekonomik, duhet të vërtetojë se mund të sigurojë të paktën 1 (një) pajisje laboratorike, për të bërë të mundur matjen e çdo parametri të listuar. OE duhet të paraqesë një deklaratë, ku për çdo parametër të listuar në shtojcën Nr.5 të vërtetojë se disponon një pajisje laboratorike dhe të shpjegojë se si do të realizohet matja e secilit parametër.

* Faturën e blerjes (në rast pronësie) ose

* Kontratën e qirasë (në rastin e marrjes me qira).

OE "Tenuis Laboratories" në dokumentat e ngarkuara ne sistem ka paraqitur nje deklarate ne te cilen deklarone se permbush te gjitha kerkesat dhe specifikimet per kryerjen e sherbimit per cdo parameter te analizave Kimiko-Fizike , sipas shtojces Nr 5 te Dst , por nuk ka listuar pajisjet laboratorike dhe shpjegimet perkatese se si do te realizohet matja e secilit prej parametrave te listuar ne shtojcen nr. 5 te Dst.

Në LPP nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", neni 92, pika 3, parashikohet se: 3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.

Sa mesiper, operatori "Tenuis Laboratories" sh.p.k. nuk kualifikohet.", nuk qëndron, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.2.1. Në shtojcën 8 "Kriteret e Veçanta të Kualifikimit", pika 2.3.5 "Kapaciteti teknik" autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

2.3.5 Operatori Ekonomik, duhet të vërtetojë se mund të sigurojë të paktën 1 (një) pajisje laboratorike, për të bërë të mundur matjen e cdo parametri te listuar. OE duhet të paraqesë një deklaratë, ku për çdo parametër të listuar në shtojcën Nr.5 të vërtetojë se disponon një pajisje laboratorike dhe të shpjegojë se si do të realizohet matja e secilit parametër.

Për çdo pajisje laboratorike, OE duhet të paraqesë :

- faturën e blerjes (në rast pronësie)

Ose

- kontratën e qirasë (në rastin e marrjes me qira).

III.2.2. Në shtojcën 5 "Formulari i Specifikimeve Teknike", autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

Specifikimet teknike në lidhje me Lendfillin.

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

1. Objektivat e këtij vlerësimi janë:

- të pasqyrojë emisionet e lëngeta, cilësinë e tyre dhe ndikimin e tyre në ujrat pritëse;
- të pasqyrojë nivelin e grimcave të ngurta pezull në ajër;
- të pasqyrojë nivelin e zhurmës së aktivitetit dhe edukimit në popullatën lokale;
- të pasqyrojë nivelin e gazeve të emetuar në ajër;
- të kryjë një vëzhgim të përgjithshëm mbi ndotjen dhe ndikimet evidente në mjedisin përreth zones së aktivitetit;
- të nxjerrë rezultate në lidhje me performancën e përgjithshme mjedisore të aktivitetit;
- të japë rekomandime për përmirësime të mundshme teknologjike dhe menaxhimi që mund të sjellin ulje të ndikimit në mjedis.

2. Në tabelat e mëposhtme paraqiten parametrat që do të monitorohen per lendfillin sipas

- Kushti 7-Shkarkimet,
- Kushti 9-Zhurmat dhe vibracionet,
- Kushti 11-Monitorimi dhe sipas Shtojcave në lejen mjedisore mjedisore përkatëse me PN-1423-12-2015

Parametrat e ujit qe do te analizohen.

Nr.	Parametri mjedisor qe monitorohet	Vendi i mostrimit
1	<i>ph</i>	<i>Ujera siperfaqesore, Shkarkim ne kanalizime</i>
2	<i>Temperatura</i>	<i>Ujera siperfaqesore, Shkarkim ne kanalizime</i>
3	<i>DO</i>	<i>Ujera siperfaqesore, Shkarkim ne kanalizime</i>
4	<i>BOD5</i>	<i>Ujera siperfaqesore, Shkarkim ne kanalizime</i>
5	<i>COD</i>	<i>Ujera siperfaqesore, Shkarkim ne kanalizime</i>
6	<i>N-NH4</i>	<i>Ujera siperfaqesore, Shkarkim ne kanalizime</i>
7	<i>Rrjedhja ditore</i>	<i>Ujera siperfaqesore, Shkarkim ne kanalizime</i>
8	<i>Rrjedhja maksimale</i>	<i>Ujera siperfaqesore, Shkarkim ne kanalizime</i>
9	<i>Perberesit organike te fosforit</i>	<i>Ujera siperfaqesore</i>
10	<i>P total</i>	<i>Ujera siperfaqesore, Shkarkim ne kanalizime</i>
11	<i>Lende pezull</i>	<i>Shkarkim ne kanalizime</i>
12	<i>N-total</i>	<i>Shkarkim ne kanalizime</i>
13	<i>P-total</i>	<i>Shkarkim ne kanalizime</i>
14	<i>TSS</i>	<i>Puset piezometrik</i>
15	<i>PH</i>	<i>Puset piezometrik</i>
16	<i>Turbiditeti</i>	<i>Puset piezometrik</i>
17	<i>Lendet pezull</i>	<i>Puset piezometrik</i>
18	<i>Konduktiviteti elektrik</i>	<i>Puset piezometrik</i>
19	<i>Oksigjeni i tretur</i>	<i>Puset piezometrik</i>
20	<i>BOD5</i>	<i>Puset piezometrik</i>
21	<i>COD</i>	<i>Puset piezometrik</i>
22	<i>DO</i>	<i>Puset piezometrik</i>
23	<i>Amonia N/NH3/NH4</i>	<i>Puset piezometrik</i>
24	<i>Azot Total</i>	<i>Puset piezometrik</i>
25	<i>Fosfor Total</i>	<i>Puset piezometrik</i>
26	<i>Perberesit organike te fosforit</i>	<i>Puset piezometrik</i>

27	Cl-	Puset pieozometrik
28	Arseniku	Puset pieozometrik
29	Bakri	Puset pieozometrik
30	Plumbi	Puset pieozometrik
31	Nikeli	Puset pieozometrik
32	Kromi VI	Puset pieozometrik
33	Zinku	Puset pieozometrik
34	Hekur	Puset pieozometrik
35	Koliform total	Puset pieozometrik

Parametrat e ajrit qe do te analizohen.

Nr.	Parametri mjedisor qe monitorohet	Vendi i mostrimit
1	Grimca te ngurta ne ajer	Ajer
2	LNP mes	Ajer
3	LNP max	Ajer
4	PM10	Ajer
5	CO	Ajer
6	NO2	Ajer
7	O2	Ajer
8	SO2	Ajer
9	CXHY	Ajer
10	VOC*	Ajer
11	Niveli i zhurmes ne mjedis per parametrat Laeq, Lamax	Sipas pikave te percaktuara ne leje mjedisore

RAPORTIMET Sipas urdhrít nr.126 datë 10.06.2022 “Per procedurën e dorëzimit/pranimit të dokumentave dhe raporteve të vetëmonitorimit, për subjektet e pajisur me leje mjedisitë tipit A ose B”, të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit

Bazuar në Urdhrin me Nr.126 datë 10.06.2022 “Per procedurën e dorëzimit/pranimit të dokumentave dhe raporteve të vetëmonitorimit, për subjektet e pajisur me leje mjedisitë tipit A ose B”, dokumentat per Zbatimin e Kushteve Vjetore

Nr.	Emertimi i Dokumentit	Kushti i lejes Mjedisore
1	Dokumentacioni lidhur me menaxhimin e perberesve te mjedisit per instalimin/impiantin	2
2	Programi i menaxhimit te mjedisit	2.9.2
3	Regjistri i Shkarkimit dhe Transferimit te Ndotjes – Raporti per vitin paraardhes	2.9.2
4	Regjistri i Shkarkimit dhe Transferimit te Ndotjes – Propozim per vitin aktual	2.9.2
5	Raport permbledhes mbi rezultatet e monitorimit te zhurmes	2.9.2
6	Pershkrimi i monitorimit te mjedisit	2.9.2

7	<i>Pershkrimi i Incidenteve/Aksidenteve</i>	2.9.2
8	<i>Raport permbledhes per Auditimin e Eficences se Energjise</i>	2.9.2
9	<i>Raport per vleresimin e eficences se shfrytezimit te lendeve te para dhe reduktimin e gjenerimit te mbetjeve</i>	2.9.2
10	<i>Menaxhimi i mbetjeve</i>	2.9.2
11	<i>Raport Permbledhes per Auditimin e Eficences se Ujit</i>	2.9.2
12	<i>Deklarate mbi masat per parandalimin e ndotjes se mjedisit dhe veprimet e rehabilitimit</i>	2.9.2
13	<i>Program i Menaxhimit te Rriskut</i>	2.9.2
14	<i>Plan i Perputhshmerise</i>	2.9.2
15	<i>Plani i cmontimit ose rehabilitimit</i>	2.9.2
16	<i>Lendet e para dhe shfrytezimi I energjise</i>	10
17	<i>Dokumentimi dhe Raportimi</i>	12
18	<i>Raport mbi ankesat</i>	
19	<i>Incidentet dhe veprimet gjate emergjencave</i>	13
20	<i>Cmontimi, rehabilitimi dhe kontrolli pas nderprerjes se operacioneve</i>	14
21	<i>Raporti Vjetor i Monitorimit</i>	

Bazuar në Urdhrin me Nr.126 datë 10.06.2022 “Per procedurën e dorëzimit/pranimit të dokumentave dhe raporteve të vetëmonitorimit, për subjektet e pajisur me leje mjedisi të tipit A ose B” **dokumentat per Zbatimin e Kushteve 3 Mujore**

Nr.	Emërtimi i dokumentit	Kushti i lejes Mjedisore
1	<i>Vendndodhja e ushtrimit te veprimtarise</i>	1.6
2	<i>Njoftimet</i>	6
3	<i>Shkarkimet</i>	7
4	<i>Plani i menaxhimit te tretesave organike</i>	7
5	<i>InspektimeVizualeDitore/Javore/Mujore per instalimet dhe shkarkimet ne ajer, uje, toke, zhurme, mbetje.</i>	7
6	<i>Mirembajtja/Plani i Sherbimeve</i>	7
7	<i>Menaxhimi i mbetjeve</i>	8
8	<i>Plani i Menaxhimit te mbetjeve</i>	8
9	<i>Zhurmat dhe Vibracionet</i>	9
10	<i>Monitorimi</i>	11
11	<i>Dokumentimi dhe Raportimi</i>	12
12	<i>Raporti Periodik i Monitorimit</i>	12

III.2.3. Në shtojcën 9 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

Shtojca 9.

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	----- --
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	----- -
E-mail:	----- -----

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- **Informacione për nënkontraktorin**

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT -i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

- Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
<p>Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.</p> <p><i>Sqarimenëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:</p> <p>_____</p> <p>_____</p> <p>etj.</p>

nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.

Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

B: DEKLARATA “Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura”

Ne cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, në mbështetje të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe në mbështetje të Ligjit Nr.9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, bëj këtë deklaram dhe garantoj se deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:

1. Unë kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj Deklarate;
2. Unë kuptoj që oferta e paraqitur do të s’kualifikohet dhe/ose përjashtohet nga fitimi i kontratave publike, nëse kjo Deklaratë vërtetohet se nuk është e plotë dhe / ose e saktë në çdo aspekt;
3. Unë jam i autorizuar nga Ofertuesi të firmos këtë Deklaratë dhe të paraqes ofertë në interes të Ofertuesit;
4. Çdo person, firma e të cilit shfaqet në dokumentacionin e ofertës, është i autorizuar nga Ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në interes të Ofertuesit;
5. Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, unë kuptoj që fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që:
 - a) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor;
 - b) është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.
6. Ofertuesi deklaron se: (kliko një nga alternativat e mëposhtme):
 - a) Ofertuesi ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër;
 - b) Ofertuesi është konsultuar, ka komunikuar, ka bërë marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet bashkangjitur, në detajet e kësaj oferte, janë përfshirë emrat e konkurrentëve, natyra dhe shkaqet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes apo angazhimit (rasti i bashkimit të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit).
7. Në veçanti, pa kufizuar paragrafët 6. a) dhe 6. b), të përmendur më lart, nuk ka pasur konsultime, komunikime, kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me:
 - a) çmimet ;
 - b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;
 - c) qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,
 - d) paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.
8. Përveç kësaj, nuk ka pasur konsultime, komunikime, marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë, përveç se kur janë deklaruar sipas paragrafit të mësipërm 6. b).
9. Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t’u bëhen të njohura me qëllim nga Ofertuesi konkurrentëve të tjerë, në çdo mënyrë qoftë, para datës dhe kohës së hapjes

zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj ose nëse deklarohen në mënyrë specifike sipas paragrafit 6.b).

C: DEKLARATA “Mbi Konfliktin e Interesit”

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon: Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.

Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:

- Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtorit i Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

- Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie.

Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. **bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit.**

Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive, si dhe Ligji Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik".

Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu.

D: DEKLARATA “Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës”

Deklarata
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:
<ul style="list-style-type: none"> • Operatori ekonomik _____ garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi. • Operatori ekonomik _____ lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi. • Operatori ekonomik _____ nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.
<i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i>

Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit

A: DEKLARATË “Në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës”

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojnë të gjitha specifikimet teknike, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga Autoriteti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me Listën e mallrave dhe grafikun e lëvrimit të përcaktuar nga Autoriteti kontraktor.	Po [] Jo []

B: DEKLARATË

Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:	<u>Punonjës</u> Po [] Jo [] Nëse, po, numri i punonjësve:

Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.	Profili i punonjësve
	<u>Makineri e mjete</u> Po [] Jo [] Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete:
Emri, Mbiemri _____ Firma _____ Vula _____ Data e dorëzimit të deklaratës _____	

Ju lutemi sigurohuni që:

- Secili pjesëmarrës i renditur në një bashkim operatorësh ekonomikë të paraqesë një Formular të veçantë të Vetëdeklarimit.
- Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.
- Çdo vetdeklarim i pavërtetë/pasaktë nga ana e operatorëve ekonomikë jo vetëm që përbën shkak për skualifikimin nga procedura konkrete, por përbën shkak dhe për përjashtimin e tyre nga e drejta për të fituar kontrata publike deri në 3 vjet, sipas parashikimeve të ligjit për prokurimin publik.
- Operatorët ekonomikë që ofertojnë në procedurat e prokurimit të vetdeklarojnë në çdo rast informacionin e saktë që i korrespondon gjendjes së tyre faktike.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik për sa më sipër.

- *Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike.*

Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

- ***Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.***

III.2.4. Nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (S.P.E) për plotësimin e kriterit të mësipërm, operatori ekonomik ankimues “Tenuis Laboratories” SHPK ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, ku në shtojcën 9, Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit; B: Deklaratë Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen):

Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:	<u>Punonjës</u>
Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e	Po [X] Jo [] Nëse, po, numri i punonjësve:

vërtetohet këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.	14 Profili i punonjësve PHD, Msc Kimist, biolog, inxh. mjedisi <u>Makineri e mjete</u> Po [X] Jo [] Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete: Automjet Caddy me targë Leje qarkullimi Caddy me targë Kontroll teknik Caddy me targë
Emri, Mbiemri <u>Doriana Islami</u> Firma _____ Vula _____ Data e dorëzimit të deklaratës <u>19/02/2024</u>	

- Dokumentin “Deklaratë” Nr. Prot: 45 datë 19.02.2024 ku citohet “*Tenuis Laboratories shpk me vendodhje në Koxhas, Xhafzotaj, Maminas, Durrës dhe Nipt L81904506I dhe përfaqësues ligjor Z. D.I, ju bën me dije që përmbush të gjitha kërkesat dhe specifikimet për kryerjen e shërbimit për çdo parametër të analizave kimiko – fizike sipas shtojcës Nr.5 për procedurë për tender me numër reference REF-948282-02-08-2024. Laboratori është i akredituar nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme e Akreditimit me nr.Certifikate LT 122.*”

III.2.5. Në nenin 77 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiron vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe

personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

Në nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht : *“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.”*

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: *“3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”*

III.2.6. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: *“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.*

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

ë)operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

f)operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

g)operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

gj)operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

h)operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);

i)operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;

j)informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;

k)operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të V, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj

Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

7.Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.”

III.2.7. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Sa më sipër, nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit, konstatohet se autoriteti kontraktor në lidhje me kriterin 2.3.5 ka parashikuar “*Operatori Ekonomik, duhet të vërtetojë se mund të sigurojë të paktën 1 (një) pajisje laboratorike, për të bërë të mundur matjen e cdo parametri te listuar. OE duhet të paraqesë një deklaratë, ku për çdo parametër të listuar në shtojcën Nr.5 të vërtetojë se disponon një pajisje laboratorike dhe të shpjegojë se si do të realizohet matja e secilit parametër.*

Për çdo pajisje laboratorike, OE duhet të paraqesë :

- *faturën e blerjes (në rast pronësie)*
Ose
- *kontratën e qirasë (në rastin e marrjes me qira). ”*

Sa më sipër, edhe pse kërkesat në lidhje me mjetet dhe pajisjet, referuar nenit 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, pika 2/i, në fazën e ofertimit do të konsiderohen të përmbushura nëpërmjet formularit përmbledhës së vetëdeklarimit, vetë autoriteti kontraktor në kriterin 2.3.5 ka parashikuar që në këtë fazë, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin gjithashtu « ... një deklaratë, ku për çdo parametër të listuar në shtojcën Nr.5 të vërtetojë se disponon një pajisje laboratorike dhe të shpjegojë se si do të realizohet matja e secilit parametër. »

III.2.8. Në rastin konkret, nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik vihet re, se në përmbushje të kriterit të mësipërm operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar dokumentin “Deklaratë” Nr. Prot: 45 datë 19.02.2024 ku citohet “*Tenuis Laboratories shpk me vendodhje në Koxhas, Xhafzotaj, Maminas, Durrës dhe Nipt L81904506I dhe përfaqësues ligjor Z. D.I, ju bën me dije që përmbush të gjitha kërkesat dhe specifikimet*

për kryerjen e shërbimit për çdo parametër të analizave kimiko – fizike sipas shtojcës Nr.5 për procedurë për tender me numër reference REF-948282-02-08-2024. Laboratori është i akredituar nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme e Akreditimit me nr.Certifikate LT 122.”, dokument në të cilin nuk pasqyrohen kërkesat e autoritetit kontraktor në pikën 2.3.5 të Kapacitetit teknik, të dokumentave të tenderit.

Akoma më tej, nga verifikimi i Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik “Tenuis Laboratories” SHPK, të cilin në zbatim të parashikimeve ligjore në fuqi, autoriteti/enti kontraktor e pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, konstatohet se operatori ekonomik ankimues nuk ka deklaruar se disponon asnjë mjet në përmbushje të kriterit 2.3.5 të Kapacitetit teknik.

Sa më sipër, Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit, në zbatim të parashikimeve ligjore në fuqi, autoriteti/enti kontraktor e pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta,dhe vetëm përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26, të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike, duke i rezervuar në këtë mënyrë të drejtën autoritetit kontraktor të kryejë verifikime në rast nevojë apo të dërgojë kërkesa për sqarim mbi dokumentacionin e paraqitur nga operatorët ekonomikë.

Komisioni gjykon, se autoriteti kontraktor në fazën e vlerësimit procedural në të cilën ndodhet aktualisht procedura e prokurimit objekt-ankimi, për përmbushjen e kriterëve të kualifikimit, duhet t’i referohet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, dhe vetëm përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26, të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Në këtë kuadër, Komisioni gjykon, se operatori ekonomik “Tenuis Laboratories” SHPK në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, nuk ka deklaruar asnjë mjet në përmbushje të kriterit 2.3.5 “Kapaciteti teknik”, në seksionin përkatës të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, fakt i cili sjell mospërmbushjen e kriterëve të kualifikimit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit në pikën 2.3.5 të kapacitetit teknik.

Akoma më tej, nga një korrespondencë e mëparshme midis Komisionit të Prokurimit Publik dhe Agjencisë së Prokurimit Publik, me shkresën nr. 319/1 prot., datë 19.01.2022 protokolluar me tonën nr. 2472/5 prot., 21.01.2022, Agjencia Prokurimit Publik njofton Komisionin e Prokurimit Publik ndër të tjera se: [...] *Kriteri për kualifikim mbi disponimin e punonjësve, duhet të përmbushet, nëpërmjet paraqitjes së Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit nga operatori ekonomik, sipas shtojcës 8 të DST. Qëllimi i paraqitjes së deklaratës “Mbi disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme” në këtë shtojcë, është garantimi i*

ekzekutimit të kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, pra që operatori ekonomik ka stafin teknik sipas të dhënave të kërkuara. Referuar sa më sipër, plotësimi i kësaj deklaratë do të jetë në lidhje me numrin e punonjësve, nëse do të jetë kërkuar, dhe profilin e tyre, sipas kërkesave specifike të vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit të një procedure prokurimi [....].

Në përfundim të argumentimit të mësipërm, Komisioni arrin në konkluzionin, se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “Tenius Laboratories” SHPK në procedurën e prokurimit në këtë fazë, nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe si i tillë nuk konsiderohet i vlefshëm.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Eko-Studio-Projekt” SHPK, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, e thjeshtuar”, me Nr.REF-94828-02-08-2024, me objekt “Monitorimi i Parametrave Mjedisore dhe Hartimi i Raporteve Mjedisore per Landfillin”, me fond limit 3,000,000 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 20.02.2024, nga autoriteti kontraktor, ECO-ELB SHA.
2. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Tenius Laboratories” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit.
3. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
4. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifave financiare të paguara nga operatori ekonomik “Eko-Studio-Projekt” SHPK.
5. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifave financiare të paguara nga operatori ekonomik “Tenius Laboratories” SHPK.

6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Kryetar
Jonaid Myzyri